

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7841
E hënë, 22 korrik 2024
Çmimi 0.50

Instituti
Hidrometeorologjik:
Kjo javë do të jetë
më e freskët | FAQE 6



BIDEN TËRHIQET NGA GARA PËR PRESIDENT, I OFRON MBËSHTETJE KAMALA HARRISIT | FAQE 4



Presidenti amerikan, Joe Biden, ka bërë të ditur se do të tërhiqet nga gara për zgjedhjet presidenciale të nëntorit dhe i ka ofruar mbështetje

nënpresidentes, Kamala Harris për t'i hyrë garës. Përmes një deklarate të lëshuar në rrjetet sociale, Biden ka thënë se beson që tërheqja nga gara

është në interesin më të mirë për Partinë Demokratike dhe SHBAnë, në mënyrë që të fokusohet tërsisht në kryerjen e mandatit që ka aktualisht

**SHPËRTIMI NË
UJMAN, KURTI:
SERBISË NUK
I LEVERDIS
NORMALITETI
I KRIJUAR NË VERI**



**QINDRA EURO LARG
PAGËS PËR 'JETË TË
DINJITETSHME'** | F. 7



RENOVA
PUTZ

Maqedoni
Xheçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



AKTUALE



**NETANYAHU TAKON BIDENIN TË
MARTËN NË SHBA** | F. 2

**GJASHTË RASTE TË DHUNËS NË
FAMILJE BRENDA 24 ORËVE NË
KOSOVË, VIKTIMA GRATË** | F. 6

**AGK-JA DËNON KËRCËNIMET NDAJ
GAZETARËVE PAS RAPORTIMEVE
PËR FATON HAJRIZIN** | F. 5

EKONOMI



**AUV RRIT KONTROLLIN NDAJ
PRODUKTEVE TË SHPENDËVE QË
IMPORTOHEN NGA BRAZILI** | F. 7

**BOK-JA IA TRANSFERON QEVERISË
MBI 10 MILIONË EURO** | F. 7

SPORT



**MERSIM ZEQIRI ME ZEMËR LUANI, I
FITON TITUJT INTERNACIONAL UBO
DHE UBF** | F. 10

Netanyahu takon Bidenin të martën në ShBA

UASHINGTON, 21 KORRIK - Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, do të takohet të martën me presidentin amerikan, Joe Biden, ka bërë të ditur zyra e liderit izraelit. Netanyahu pritet të niset të hënën drejt Shteteve të Bashkuara. Dy liderët janë takuar për herë të fundit personalisht në Tel Aviv më 18 tetor, pak pas sulmit të kryer nga Hamasi në jug të Izraelit, më 7 tetor. Atë ditë, militantët e Hamasit - grupit të shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian - kanë vratë mbi 1.200 izraelitë dhe kanë

marrë peng rreth 240 të tjera. Rreth 116 pengje besohet se janë ende në Gazë, përfshirë 42 që ushtria izraelite beson se janë të vrarë. Izraeli, më pas, ka nisur fushatë në Gazë për të shkatërruar Hamasin. Si pasojë e ofensivës tokësore dhe ajrore të Izraelit në atë rajon janë vratë më shumë se 38.000 palestinezë, raportojnë autoritetet shëndetësore palestinezë. Sipas raportimeve në media, diskutimet pritet të fokusohen në tentimet për të garantuar një armëpushim në Gazë dhe lirim të pengjeve, në këmbim të të burgosurve palestinezë.

Ndërkohë, në Izrael po rriten kritikat për udhëtimet e Netanyahut jashtë vendit. Protestuesit kërkojnë që ai të largohet nga Izraeli vetëm pasi të jetë arritur një marrëveshje përlirim pengjesh. Të mëkurën Netanyahu do t'i adresohet Kongresit amerikan, lidhur me veprimet e ushtrisë izraelite në Gazë. Marrëdhëniet në mes të Bidenit dhe Netanyahut konsiderohet të janë të tensionuara, sidomos pas një videoje të publikuar së fundmi prej liderit izraelit, në të cilën ai kritikon ashpër Qeverinë amerikane për pezullim të një pjesë të ndihmës ushtarake.



Microsoft: Problemi kibernetik preku 8.5 milionë pajisje Windows



NJU JORK, 21 KORRIK - Gjiganti Microsoft vlerëson se 8.5 milionë kompjuterë në gjithë botën janë përballur me probleme kibernetike në ditët e fundit. Kjo është shifra e parë që tregon për seriozitetin e incidentit, dhe ka sugjerime që mund të ketë qenë incidenti më i keq kibernetike në histori. Kaosi është shkaktuar për shkak se kompania për siguri kibernetike, Crowdstrike, e ka bërë një gabim në përditësim të sistemit dhe për pasojë janë

pamundësuar shumë operacione. Në mesin e bizneseve të prekura kanë qenë aeroportet, bankat dhe spitalet. Zëvendëspresidenti i Microsoftit, David Weston, ka thënë se shifra prej 8.5 milionë pajisjeve është më pak se 1 përqind e të gjitha pajisjeve Windows në botë. Ky gjigant teknologjik ka thënë se incidenti ka vënë në pah rëndësinë që kompanitë sikurse Crowdstrike të bëjnë kontroll të vazhdueshme nëpër proceset e

përditësimit, para se t'i lëshojnë në publik. Kaosi i madh që është shkaktuar ka rritur ndërkohë paralajmërimet nga ekspertët që, hakerët mund të shfrytëzojnë këtë mundësi përtë probleme. Shefi i kompanisë Crowdstrike, George Kurtz, i ka inkurajuar klientët që të sigurohen se po flasin me një përfaqësues të kompanisë, para se të shkarkojnë diçka nëpër pajisjet e tyre.

Europoli paralajmëron përritje të krimít të organizuar

HAGË, 21 KORRIK - Krimi i organizuar është duke u përhapur nëpër Evropë, sipas agjencisë së Bashkimit Evropian përsundim të ligjit, Europol. "Krimi i organizuar është në rritje. E shfrytëzon secilën dobësi", ka thënë shefja e Europolit, Catherine De Bolle për revistën gjermane Der Spiegel, transmeton dpa. "Rritja e tregtisë së drogës është duke nxitur dhunën", ka thënë De Bolle. Sipas Europolit, prodhimi i kokainës në Amerikën Qendrore

dhe Jugore është në pikun e vet dhe Evropa është e larë në drogë. "Situata është dramatike", ka thënë De Bolle, duke përmendur se po vërehet rritje e tregtisë edhe për droga tjera. Sipas hulumtimeve të autoritetit policorl, me bazë në Hagë, në BE janë aktive 821 rrjete serioze kriminale. Këto rrjete, me më shumë se 25.000 anëtarë, janë shumë profesionale dhe të pamëshirshme, ka paralajmëruar Europol. Sipas hulumtimeve, biznesi i tyre

kryesor është trafikimi i drogës. De Bolle ka thënë se paratë e fituara prej drogës në Evropë, zakonisht qëndrojnë brenda kontinentit dhe investohen në ekonomi lokale. "Kjo e bën krimin e organizuar një prej kërcënimeve më të mëdha të kohës sonë". Sipas saj, policia ka nevojë përpajisje teknike dhe personel, përtë pasur mundësi që t'i luftojë këto rrjete. "Nëse nuk investojmë më shumë, ne do ta humbim luftën", ka thënë mes tjerash ajo.



Gjkata në Bangladesh anulon shumicën e kuotave përvende pune që nxitën trazira



DHAKA, 21 KORRIK - Gjkata Supreme e Bangladeshit ka anuluar të dielën shumicën e kuotave përvende të punës në institucionë qeveritare, mirëpo nuk ka plotësuar tërësisht kërkësat e studentëve, të cilët kanë mbajtur protesta vdekjeprurëse në ditët e fundit. Autoritetet kanë raportuar se 151 persona kanë vdekur si

pasojë e përlleshjes së studentëve me forca të sigurisë. Këto protesta kanë shënuar një prej trazirave më të rënda gjatë udhëheqësisë së kryeministres Sheikh Hasina. Ushtarat janë duke patrulluar në gjithë Bangladeshin, pasi polica nuk ka arritur të mbajë rendin, ndërsa linjat e

internetit dhe komunikimeve janë kufizuar ashpër prej të enjtes, duke izoluar këtë shtet me pjesën tjetër të botës. Gjkata Supreme ishte planifikuar të merrete vendim përtë këtë rast përgjatë muajit Gusht, mirëpo ka dalë me një vendim të dielën, për shkak të përshkallëzimit të dhunës.

PDK-ja kërkon dorëheqjen e ministres së Drejtësisë dhe intervistimin e saj në Prokurorinë Speciale

Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, të dielën, përmes një konference për medie, ka kërkuar dorëheqjen e ministres së Drejtësisë dhe i ka bërë thirrje Prokurorisë Speciale që menjëherë të ftojë atë në intervistim për të sqaruar deklaratat e saj të fundit në lidhje me arratisjet e të burgosurve nga burgjet e Kosovës. "Nëse Serbia është prezente në burjet e Kosovës, çfarë bën ministria e Drejtësisë në detyrën e saj? Kjo është pyetja themelore që ngre çdo qytetar sot", ka thënë ai



EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 KORRIK - Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, të dielën, përmes një konference për medie, ka kërkuar dorëheqjen e ministres së Drejtësisë dhe i ka bërë thirrje Prokurorisë Speciale që menjëherë të ftojë atë në intervistim për të sqaruar deklaratat e saj të fundit në lidhje me arratisjet e të burgosurve nga burgjet e Kosovës. "Nëse Serbia është prezente në burjet e Kosovës, çfarë bën ministria e Drejtësisë në detyrën e saj? Kjo është pyetja themelore që ngre çdo qytetar sot. Kjo deklaratë ngre çështje serioze të sigurisë kombëtare të vendit dhe nuk mund të mbetet pa u sqaruar", ka thënë Gruda.

Gruda ka thënë se shërbimi Korrektaues i Kosovës, si një agjenci

ekzekutive e sigurisë që operon nën Ministrinë e Drejtësisë, është përgjegjës për këto raste. "Kjo deklaratë, për mua dhe Partinë Demokratike të Kosovës përbën një akt dorëzimi të ministres së Drejtësisë përballë detyrimeve të saj ndaj kushtetutës, ligjt dhe qytetarëve të Kosovës. Kjo është një situatë e paprecedent që tregon inkompetencën, papërgjegjshmërinë dhe dështimin e ministres Haxhiu", ka thënë më tej anëtari i Kryesisë së PDK-së.


Më tej, ai ka thënë se është fatkeqësi që deri më tash nuk ka ardhur asnjë përgjigje, asnjë masë dhe asnjë përgjegjësi nga Ministria e Drejtësisë. "Qytetarët e Kosovës nuk meritojnë një Ministre të tillë të Drejtësisë, që përvëçse nuk arrin të realizojë asnjë nga premtimet e dhëna, bën deklarime disfatiste që dëmtojnë rendin dhe ligjin në Kosovë", ka thënë Gruda.

Gruda ka thënë se shërbimi

shumë të nevojshme në sistemin e drejtësisë në Kosovë", ka thënë Gruda. Sipas tij, Kosova ka nevojë për një drejtim të ri në fushën e drejtësisë që do t'u garantojë sigurinë qytetarëve, respektimin e ligjit dhe kthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Ministria e Drejtësisë në Kosovë, Albulena Haxhiu, ka bërë thirrje të shtrunën për nisjen e një hetimi vendor dhe ndërkombëtar për, siç ka thënë ajo, nxitjen dhe organizimin e arratisjeve të të burgosurve nga burgjet e Kosovës për në territorin e Serbisë. Sipas saj, shteti i Serbisë po cyt dhe organizon arratisjen e të burgosurve, paraburgosurve dhe

të kërkuarve nga drejtësia e Kosovës, në këmbim të një "ambienti mburojë ndaj pandeshkueshmërisë e ndjekjes penale të kriminelëve nga aorganet e Republikës së Kosovës". "Një mbështetje e tillë është padyshim e qëllimshme, e organizuar dhe e lidhur me qëllimin për të dëmtuar rendin publik, kushtetues e ligjor të Republikës së Kosovës", ka thënë Haxhiu, pa ofruar ndonjë dëshmi për këto pretendime. Ajo e ka bërë këtë postim në rrjetin social Facebook, një ditë pasi i arratisuri nga burgu i Smrekonicës në Kosovë, Faton Hajrizi, është raportuar të jetë vrarë nga autoritetet në Serbi.

Shpërthim në afërsi të Ujmanit, dëmtohen dy vetura



PRISHTINË, 21 KORRIK - Policia e Kosovës e ka konfirmuar se të dielën ka ndodhur një shpërthim në pjesën veriore të vendit, në afërsi të Likenit të Ujmanit.

Zëvendësdrëjtori i Policisë së Kosovës për pjesën veriore, Veton Elshani, ka thënë për Radion Evropa e Lirë se nuk ka

të lënduar, por vetëm dëme materiale në dy vetura.

Ai nuk e ka specifikuar saktë se për çfarë shpërthimi bëhet fjalë. Elshani ka thënë se policia është duke u marrë me rastin.

Qytetarët të zonës janë parë në javët e fundit duke u freskuar afër likenit, pas temperaturave të larta, gati 40 gradë celsius.

Ky ligen konsiderohet pikë strategjike vitale për Kosovën, pasi pos tjerash, aktualisht furnizon me ujë, një zonë me mbi 500 mijë kosovarë. Nga Ujmani furnizohen me ujë shtatë komuna, në jug dhe veri të lumit Ibër; Mitrovica e Jugut dhe e Veriut, Zveçani, Vushtrria, Glogoci, Skenderaj dhe një

Shpërthimi në Ujman, Kurti: Serbisë nuk i leverdis normaliteti i krijuar në veri

Ndaj kësaj ngjarje ka reaguar kryeministri Albin Kurti, i cili ka thënë se Serbisë dhe qarqeve të caktuara mike me të, nuk iu leverdis normaliteti i krijuar në atë pjesë të vendit tonë. "Duke e humbur ndikimin në këtë zonë, nervoza u bëhet agresivitet. Edhe grupe të ndryshme kriminale, pak a shumë të lidhur me të, kanë humbur mundësinë për përfitime enorme çfarë i patën për më shumë se dy dekada që nga çlirim i Kosovës. Kjo është e dhimbshme për ta dhe vështirë e pranueshme. Por, rrugë tjetër nuk ka. Sundimi i

pjesë e Prishtinës. Pos tyre, termocentralet Kosova A dhe B, Trepça dhe Ferronikeli varen tërësisht nga furnizimi me ujë nga ky lige artificial. Po ashtu, prodhohen edhe 32 Megavat (MË) rrymë në hidrocentralin e Vallaçit. Lumi Ibër, që e mbush me ujë Ujmanin, buron në Mal të Zi, më pas kalon nëpër territorin e Serbisë, hyn në Kosovë me një gjatësi të shtratit prej 82 km, dhe prapë kthehet në Serbi.



Biden tërhiqet nga gara për president, i ofron mbështetje Kamala Harrisit

Presidenti amerikan, Joe Biden, ka bërë të ditur se do të tërhiqet nga gara për zgjedhjet presidenciale të nëntorit dhe i ka ofruar mbështetje nënpresidentes, Kamala Harris për t'i hyrë garës.

Përmes një deklarate të lëshuar në rrjetet sociale, Biden ka thënë se beson që tërheqja nga gara është në interesin më të mirë për Partin e Demokratike dhe SHBA-në, në mënyrë që të fokusohet tërësisht në kryerjen e mandatit që ka aktualisht.

Ky vendim vjen pas thirrjeve në rritje për largim të Bidenit nga gara për zgjedhjet e nëntorit, sidomos pas një debati që ka zhvilluar me kandidatin e republikanëve për president,

Donald Trump, në të cilin nuk ka pasur performancë të mirë. "Ka qenë nderi më i madh i jetës sime që të shërbej si president", ka thënë Biden, duke paralajmëruar që do të flasë më shumë gjatë javës lidhur me këtë vendim.

Biden, 81-vjeçar është infektuar më herët gjatë javës me koronavirus dhe është në izolim në shtëpinë e tij në Dellauer.

"E besoj sot atë që e kam besuar gjithmonë: Nuk ka asgjë që nuk mund të bëj Amerika kur jemi të bashkuar. Duhet të rikujojmë që jemi Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka thënë Biden.

Ai ka thënë se i ofron mbështetje të plotë nënpresidentes aktuale, Kamala Harris, për t'u bërë e

nominuara e demokratëve për presidente.

"Vendimi im i parë si i nominuar i partisë më 2022 ka qenë kur zgjodha Kamala Harrisin për pozitën e nënpresidentes. Ka qenë vendimi më i mirë që kam marrë", ka thënë ai.

"Demokratë, është koha të bashkohemi dhe të mundim Trumpin. Le ta bëjmë këtë", ka thënë Biden.

Biden u ka rezistuar mejavë thirrjeve për t'u tërhequr nga gara, duke thënë se është personi më i mirë për të mposhtur Trumpin, 78-vjeçar.

Biden e ka mposhtur Trumpin më 2020, duke garantuar fitore në shtetet kritike si Pensilvania, Uiskonsin dhe Miçigan.

Konventa e Demokratëve, në të cilën emërohet zyrtarisht kandidati për president, do të mbahet më 19-22 gusht në Çikago, Illinois.

Nëse zgjidhet si kandidate demokrate, Harris, 59-vjeçare, ish-prokurore dhe senatore e Kalifornisë, do të bëhet gruaja e parë me ngjyrë në historinë amerikane, që do të garojë për presidente.

Si nënpresidente, ajo ka mbikëqyrur çështje kyçë në administratë, përfshirë imigrimin, të drejtat e votës dhe të drejtat e riprodhimit.

Disa prej emrave tjerë në mesin e demokratëve, që mund të synojnë garën janë guvernatorët si: Gavin Newsom i Kalifornisë, Gretchen Whitmer e Miçiganit dhe J.B. Pritzker i Illinoisit.

Harris është në përparësi kundrejt kandidatëve tjerë, pasi veçë ka marrë pjesë në fushatë përvjetore.

Ajo, gjithashtu, ka qasje në dhjetëra miliona dollarë të mbledhur përfshirë fushatë.

Harris ka shkallë pëllqimi të ngjashme me atë të Bidenit.

Megjithatë, ekspertët kanë thënë se ajo nuk njihet ende mirë nga shumë amerikanë dhe ka kohë të përmirësojë imazhin e vet.

Në një deklaratë të bërë në platformën e vet sociale, Social Truth, Trump ka thënë se Harris "nuk është e denjë për të garuar për presidente".

AGK-ja dënon kërcënimet ndaj gazetarëve pas raportimeve për Faton Hajrizin

PRISHTINË, 21 KORRIK - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës është thollësish i shqetësuar me një sërë videoesh kërcënuese, kryesisht në platformën Tik Tok, ndaj disa gazetarëve dhe medieve, në ditët e fundit.

Kërcënimet kanë ardhur në lidhje me raportimet për Faton Hajrizin, i arratisur nga burgu në Kosovë, dhe për të cilin raportohet se është vrarë në Serbi.

Cak i sulmeve janë bërë më së shumti Ermal Panduri, autor i emisionit "Debat Plus" në TV Dukagjini, dhe Vehbi Kajtazi,

udhëheqës i Paparaci, dhe panelist në Klan Kosova. Gjithashtu, me mesazhe fyeze e kërcënuese janë paraqitur edhe fotografitë e Jehona Bajramit të Klan Kosova dhe Durontina Bylykbashit të TV Dukagjini. Videot e kanë përshtakimin "Vrasësit e Faton Hajrizit", dhe i akuzojnë mediat dhe gazetarët se kanë kontribuar në ngjarjet në Serbi, që çuan në vrasjen e Hajrizit.

Akuzat ndaj medieve dhe gazetarëve përvëc të pabaza, janë shumë të irrezikshme dhe vënë seriozisht në rezik sigurinë

e gazetarëve të apostrofuar dhe familjeve të tyre.

AGK-ja, u bën thirrje kolegëve gazetarë që të denoncojnë individët dhe llogaritë prej nga vijnë këto kërcënimë, dhe fton Policinë e Kosovës të aktivizojë Njësitet e Krimeve Kibernetike për të gjetur dhe mbajtur përgjegjës atë që kërcënojnë.

Meqë shumë prej kërcënimëve vijnë nga jashtë Kosovës, AGK-ja pret që autoritetet e sigurisë të bashkëpunojnë me partnerët e tyre jashtë vendit, për të zbuluar autorët e kërcënimëve me jetë ndaj gazetarëve.



Qindra euro larg pagës për 'jetë të dinjitetshme'

PRISHTINË, 21 KORRIK- Bekim Muji nga Gjilani fiton 250 euro në muaj duke punuar në një kompani private të sigurimeve në Prishtinë. Kjo shumë thotë se nuk i mjafton as për të mbuluar shpenzimet elementare të familjes dhe shpesh detyrohet të marrë borxhe. "Vetë i dyti jam, me bashkëshorten, por problem. Ato para nuk mjaftojnë. Marr borxh, kthej borxh, s'ke çfarë bën... Jeta është gjithqysh", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Shumë qytetarë të Kosovës detyrohen të mbijetojnë edhe më me pak, ndërkohë që çmimet e konsumit, si gjetiu në botë, janë rritur.

Paga minimale në vend vazhdon të jetë 130 euro për punëtorët nën 35 vjeç dhe 170 euro për ata deri në 65 vjeç, ndërsa mesatarja rreth 520 euro.

Në kontinentin evropian, Kosova e ka pagën më të vogël minimale, ndërsa Luksemburgu i prin listës si shteti me pagën më të madhe minimale. Paga minimale e një shteti përcaktohet me ligj dhe zbatohet për shumicën e punonjësve të atij shteti.

Osman Mustafa, punëtor ndërtimi nga Podujeva, thotë se një jetë dinjitoze për një familje 4-anëtarëshe në Kosovë, kërkon së paku 1.000 euro në muaj.

"Te ne në ndërtimtari nuk ka pagë nën 500 euro. Është më mirë se diku tjetër, por as këto nuk mjaftojnë", thotë ai.

Qeveria ka propozuar rritjen e pagës minimale në 264 euro. Ligji nuk ka hyrë në fuqi ende, por edhe kjo shumë është larg asaj që nevojitet për një jetë të dinjitetshme, thonë studimet.

Një studim i Institutit Musine Kokalari në Prishtinë tregon se vetëm 20% e pagave në Kosovë i plotësojnë standartet për një jetë të dinjitetshme - me 1.152 euro neto në muaj, që i nevojiten një familje 4-anëtarëshe.

Radio Evropa e Lirë kërkoi nga Qeveria t'i komentojë këto gjetje dhe e pyeti nëse ka ndonjë plan përgjithshëm për jetë të dinjitetshme, por nuk mori përgjigje.

"Çdo i pesti punëtor me pagë për jetesë të dinjitetshme"

Studimi i Institutit për Politika Sociale Musine Kokalari në Prishtinë, i publikuar së voni,



tregon se një familjeje 4-anëtarëshe, për një jetesë të dinjitetshme, i nevojiten mesatarisht 1.295 euro bruto apo 1.152 euro neto për një muaj. Ndërsa, një të rrituri beqar i nevojiten mesatarisht 816 euro bruto, apo 720 euro neto. "Gjetja e këtij raporti është se vetëm një në pesë paga në Kosovë mund të konsiderohet si pagë jetese. Pra, vetëm rreth 20 për qind e totalit të pagave të llogaritshme në Kosovë e arrijnë këtë shumë, ndërsa rreth 80 për qind e tyre nuk e arrijnë", thotë përllogaritjen e pagës së jetesës, tregon ajo, janë analizuar shpenzimet e ekonomive familjare, si: kostoja për ushqim dhe pije, për veshmbathje, për banim, për mirëmbajtje të shtëpisë, për shëndet, për transport, për komunikime, për aktivitete rekreative kulturore, për restorante dhe hotele, si dhe përmallra dhe shërbime të tjera.

Burim kryesor i të dhënavë të përdorura në studim është Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare e vitit 2022, e cila është realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Gjetjeve të studimit njësoj u bën jehonë edhe Mejdi Bektashi, profesor i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës. "Paga jetesore për një familje 4-anëtarëshe, që është llogaritur në 1.150 euro (neto), është reale dhe rrallëkush mund ta kalojë muajin

nën këtë shumë të përcaktuar... sepse, viteve të fundit, kemi ngritur të çmimeve, inflacion, që është sjellë edhe në numra dyshifrorë", thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Sipas të dhënavë të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mesatarja e inflacionit në vitin 2022 ishte gati 12 për qind, ndërsa në vitin 2023 ishte gati 5 për qind.

Po sipas ASK-së, në majin e sivjetmë, çmimet e konsumit shënuan ngritje për 2.4 për qind, në krahasim me majin e vitit të kaluar

Sindikalistët: Paga minimale nuk është negociuar fare

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për pagën minimale merret në bazë të rekandimit të Këshillit Ekonomik Social.

Ligji përkëtë këshill përcakton që ai duhet të përfshijë përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, të organizatave të punëdhënësve dhe të organizatave të punëmarrësve.

Atdhe Hykoll, kryetar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, thotë se niveli i pagës minimale, i cili është vendosur nga Qeveria e Kosovës, nuk është negociuar fare me sindikalistët. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai thotë se që nga marsi i vitit të kaluar, Këshilli Ekonomik Social nuk është mbledhur asnjëherë. "Ne, si BSPK, jemi duke i bërë vazhdimisht presion Qeverisë së Kosovës që të

mblidhet Këshilli Ekonomik Social dhe të negociohet paga minimale, e cila çdoherë në fund të vitit duhet të rekandohet përmiratim. Është me ligj që në çdo fund të vitit, paga minimale të negociohet", thotë Hykoll.

Qeveria e Kosovës nuk iu përgjigji interesimit të REL-it as për punën e Këshillit Ekonomik Social.

Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, thotë se 264 euro nuk kanë më vlerë, sepse fuqia punëtore, sipas tij, ka ndryshuar.

Ai thotë se as propozimi i sindikalisteve i vitit të kaluar, që paga minimale të jetë 450 euro, tashmë nuk qëndron. "Ka qenë minimumi që ne kemi propozuar përvitin e kaluar, ndërsa përkëtë vit nuk guxojmë as të mendojmë për një pagë nën 550 euro, minimalisht", thotë Azemi për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, fuqia punëtore në Kosovë është duke rënë, për shkak të migrimit të qytetarëve të Kosovës drejt vendeve perëndimore, pas liberalizimit të vizave nga 1 janari i këtij viti.

Ndonëse nuk ka ndonjë të dhëne zyrtare se sa qytetarë të Kosovës kanë migruar jashtë vendit, mungesa e fuqisë punëtore është një nga arsyet që paga minimale në disa kompani është rritur, thotë Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, e cila përfaqëson komunitetin e bizneseve. "E para, mungesa e fuqisë punëtore. Do të thotë, është zvogëluar oferta dhe ka kërkës përmë shumë punëtorë. E dyta, është çështja se

kompanitë kanë nevojë ta ngrenë kualitetin e shërbimit ose kualitetin e produktit", thotë Rafuna.

Sipas tij, pagat minimale në sektorin privat, në të shumtën e rasteve, janë mbi 400 euro. Por, ai thotë se as kjo vlerë nuk nënkupton pagë për jetesë të dinjitetshme, për shkak të çmimeve të larta të artikujve të konsumit të përditshëm dhe inflacionit.

Si të zvogëlohet hendeku?

Bektashi thotë se zvogëlimi i hendekut ndërmjet pagës minimale në Kosovë dhe pagës për jetesë të dinjitetshme të punëtorëve, nuk është i lehtë.

Por, thotë se Qeveria e Kosovës duhet të veprojë me kohë, duke përllogaritur për çdo vit shkallën e inflacionit. "Në aspektin ekonomik, kjo diferençë mund të përafrohet vetëm nëse kemi ngritje të pagave sipas shkallës së inflacionit në vitin paraprak", thotë ai. Vlera e pagës minimale në Kosovë nuk ka ndryshuar qysht në vitin 2011 dhe ajo është më e ulëta në Evropë.

Bektashi thotë se rritja e pagave varet, gjithashtu, nga zhvillimi ekonomik i vendit.

Banka Botërore ka parashikuar përkëtë vit rritje ekonomike në Kosovë për 3.9 për qind, krahasuar me 3.2 për qind në vitin 2023.

Reth pagës minimale

Ligji për pagën minimale në Kosovë - që do ta rrisë atë në 264 euro bruto për të gjithë të punësuarit - është miratuar në korrik të vitit të kaluar, por është sfiduar në Gjykatën Kushtetuese nga disa deputetë të opozitës, për shkak të shkeljeve të pretenduara ndaj personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Por, në fund të muajit të kaluar, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë një vendim me të cilin ka konstatuar se në ligj nuk ka shkelje. Gjykata, po ashtu, ka rekomanduar që ligji t'i dërgohet presidentes Vjosa Osmani për shpallje.

Deputetja britanike takohet me Osmanin: Britania nuk duhet të lejojë rindezjen e konfliktit në Kosovë

PRISHTINË, 21 KORRIK - Deputetja britanike Alicia Kearns ka zhvilluar një takim me presidenten Vjosa Osmani, e cila po qëndron në Britani ku mori pjesë në Samitin e Komunitetit Politik Evropian. Kearns ka shkruar në "X" se

është jetike që Mbretëria e Bashkuan të mos lejojë akterët armiqësorë ta rinden konfliktin në Kosovë. "Gjithmonë kënaqësi të takohen me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, për të diskutuar për sigurinë dhe

stabilitetin në Ballkan dhe Evropë. Ajo është me të vërtetë një forcë e madhe, dhe është jetike që Mbretëria e Bashkuan të mos lejojë akterët armiqësorë të ringjallin urrejtjen dhe konfliktin në Kosovë", ka shkruar Kearns.



Instituti Hidrometeorologjik: Kjo javë do të jetë më e freskët

PRISHTINË, 21 KORRIK - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka njoftuar për parashikimin e motit për pesë ditët e ardhshme. Sipas IHK-së, moti do të jetë i ndryshueshëm dhe më i freskët se java që lamë pas.

E hënë - Mot me diell dhe pjesërisht i vranët. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 15-19 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 29-33 gradë celsius. Do të fryjë erë e lehtë deri mesatare nga drejtimi i veriperëndimit.


E martë - Mot me diell dhe i qetë, Vranësirat më të fokusuar parashihen për rrëth reliefit malor. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 14-18 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 28-32 gradë. Do të fryjë erë kryesish nga verilindja e lehtë deri mesatare.

E mërkurë - Mot me diell dhe vranësira të shpërndara. Vranësirat gjatë pjesës së dytë të ditës parashihen të sjellin riga shiu.

dhe shkarkime rrufesh. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 14-17 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 27-29 gradë celsius. Do të fryjë erë nga drejtimi i jugperëndimit me shpejtësi 1-7m/s.

E enje - Mot me diell dhe vranësira të shpërndara. Vranësirat vende-vende parashihen të sjellin riga shiu dhe shkarkime rrufesh. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 14-17 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 24-27 gradë celsius. Do të fryjë erë nga drejtime i juglindjes me shpejtësi 1-5m/s.

E premte - Mot me diell dhe pjesërisht i vranët. Vranësirat gjatë ditës vende-vende mund të sjellin riga shiu. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 13-16 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 23-26 gradë celsius. Do të fryjë erë nga drejtimi i jugperëndimit me shpejtësi 1-4m/s.



UP-ja vazhdon ngritjen në rangimin botëror të Webometrics, shënon rritje për 278 vende



PRISHTINË, 21 KORRIK - Universiteti i Prishtinës ka shënuar ngritjen më të madhe dhe renditjen me të lartë në Webometrics, prejse bëhet matja. Në renditjen e fundit të Webometrics, të përditësuar gjatë muajit korrik, UP-ja është renditur në pozitën e 2606-të në nivel botëror. Webometrics vlerëson dhe rangon mbi 32 mijë institucione të arsimt të lartë nga mbarë bota.

Në këtë mënyrë, UP-ja ka shënuar ngritje për 278 vende nga janari i këtij vitit, kur edhe është

përditësuar dhe publikuar renditja paraprake e Webometrics. Në një kohështrirje më të gjatë, përkatësisht nga korriku i viti 2022, UP-ja është ngritur për 420 pozicione më lartë.

Mbi bazë të këtyre rezultateve, përfshirë renditjen e fundit, Universiteti i Prishtinës vazhdon të mbetet institucioni lider i arsimt të lartë në mbarë bota.

Në këtë mënyrë, UP-ja ka shënuar ngritje për 278 vende nga janari i këtij vitit, kur edhe është

renditur në mesin e top 800 universitetave prej 6170 institucioneve të arsimt të lartë nga Evropa, të cilat i nënshtronë këtij rangimi. Në nivel të Evropës Qendrore dhe Lindore, UP-ja është e renditur në pozitën e 177-të nga 2692 universitete të përfshira në vlerësim. Webometrics është renditje e institucioneve të arsimt të lartë, e cila realizohet çdo gjashtë muaj nga Cybometrics Lab, që është pjesë e Këshillit Kombëtar Kërkimor të Spanjës.

Gjashtë raste të dhunës në familje brenda 24 orëve në Kosovë, viktima gratë

PRISHTINË, 21 KORRIK - Gjashtë raste të dhunës në familje janë regjistruar të shtunën në Kosovë. Sipas raportit të Policisë së Kosovës, rastet e dhunës kanë ndodhur në Lipjan, Podujevë, Pejë dhe Rahovec, dhe njëri është vazhdimi prej 18 korrikut.

Në katër raste, gratë kanë raportuar se kanë përjetuar dhunë fizike ose psikike prej bashkëshortëve të tyre.

Një rast është regjistruar për dhunë të vëllait ndaj motrës, dhe një tjetër përfundim të gjyshit ndaj mbesës.

Të shtunën janë regjistruar katër raste të dhunës në familje.

Të dhënët e Policisë së Kosovës tregojnë se, vitin e kaluar, janë raportuar 2.460 raste të dhunës në familje, me viktima kryesish gratë.

Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, numri i tyre është shumë më i lartë se shifra zyrtare.

Ata besojnë se dhuna

nëraportohet për disa arsy, përfshirë: presionin social mbi gratë, mungesën e pavarësisë së tyre ekonomike dhe mostrashëgimin e pasurisë nga prindërit.

Sipas gjetjeve të organizatës ndërkombëtare, Amnesty International, të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë janë shprehur se nuk kanë parë drejtësi, se shteti nuk është kujdesur përsigurinë e tyre dhe se ato i frikësohen përsëritjes së dhunës.

Konventa e Stambollit - për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, të cilën e ka nënshkruar Kosova – bën thirje që veçanërisht burrat dhe djemtë të kontribuojnë në parandalimin e të gjitha formave të dhunës.

Katrina Fotovat, zëvendësreprezant e Zyrës së Sekretariat amerikan të Shtetit për Çështjet Globale të Grave, i ka



thënë Radios Evropa e Lirë në prill se autoritetet amerikane kanë zbuluar se koha më e mirë për t'i angazhuar burrat në bisedat për

dhunën seksuale ose dhunën me bazë gjinore, është pasi ata të bëhen baballarë. Nga viti 2010 deri në prill të vitit

2024, në Kosovë janë vrarë 57 gra. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

IQP shqipton rreth 800 gjoba ndaj kompanive për shkeljet e të drejtave të punëtorëve

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kryeinspektori i Inspektoratit Qendror të Punës (IQP) Hekurani Nikçi, në një intervistë përmes Ekomornia Online, ka thënë se në gjashtëmujorin e parë të këtij viti kanë shqiptuar 700 e 87 gjoba për subjekte juridike që kanë shkelur të drejtat e punëtoreve. Ai ka thënë se në këtë periudhë janë inspektoarë 5 mijë e 960 subjekte juridike më shumë se për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Përgjatë kësaj periudhe Inspektorati Qendror i Punës ka shqiptuar 700 e 87 masa

shqiptara janë në lidhje me marrëdhëni e punës dhe se sektorët në sektorët e ndërtimtarisë, gastronomisë, të prodhimit. "Për janar-qershor të këtij viti 2024 (IQP) ka inspektoarë 5 mijë e 960 subjekte juridike që i bie 2 mijë e 200 e 85 mijë e 960 subjekte juridike. Sipas tij, gjobat më të mëdha të

ndëshkimore apo gjoba apo që i bie 385 gjoba më shumë se për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 2023. Marrëdhënia e punës është ajo që Inspektorati i Punës, shqipton gjoba më së shumti do të thotë që buron nga ligji i punës. Sektorët më së shumti, janë sektori i gastronomisë, sektori i prodhimit, sektori i rrjetit të marketeve e kështu më radhë", ka thënë Nikçi.



AUV rrit kontrollin ndaj produkteve të shpendëve që importohen nga Brazili

PRISHTINË, 21 KORRIK - Pas njoftimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Blegtorisë (Mapa) në Brazil për disa shtete në mesin e tyre njofton edhe Republikën e Kosovës, për suspendimin e përkohshëm të certifikimit përmes eksportet e mishit të shpendëve dhe produkteve të tij.

Pasi është konfirmuar shpërthimi i sëmundjes së Newcastle (NCD) në komunën e Anta Gorda, në Rio Grande do Sul. AUV menjëherë ka urdhëruar ngritjen e masave të kontrollit përmes gjitha ngarkesat që vijnë nga Brazili. Ku përfshihet kontroll i detajuar i se cilës ngarkesë. Përmes verifikimit të hollësishëm përmes siguruar që ngarkesa është në përpunë me rregullat ligjore që përjashtojnë çdo dyshim reziku pas situatës se re te krijuar nga shpërthimi i sëmundjes Newcastle. Njoftimi i autoritetit shtetëror të Brazilit përfshin dhe një entitetin e shtetit të Republikës



se Kosovës. Në zbatim të rregullave ndërkombëtare përmes tregtimin e shpendëve dhe produkteve të tyre i cili garanton transparencë ndaj vendeve që importojnë produktet e tyre. Certifikimi i eksporteve është

një marrëveshje dypalëshe midis vendeve dhe autoritetit Brazilian pezullon Certifikatën Ndërkombëtare të Shëndetit në mënyrë që të përbushë garancitë dhe kërkosat përmes procedurave dhe rregullave ligjore masatë e nivelit të

produkteve janë mishi i shpendëve i freskët, i ftotë ose i ngrirë i cili tregtohen në vendet e rajon ku përfshihet edhe Kosova. Në zbatim të procedurave dhe rregullave ligjore masatë e nivelit të

kontrollit do të janë në përpunë me standarde ndërkombëtare të tregimit të produkteve ushqimore përmes menaxhim bazuar në situatë. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në bashkëpunim dhe koordinim me agjencitë në kuadër të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, Policinë e Kosovës dhe Doganat e Kosovës, në kapacitet të plotë do të ekzekutojnë masat sipas urdhrit njoftues, përmes parandalim të hyrjes se ngarkesave nga zonat e prekura me sëmundjen e Newcastle. Kjo sëmundje është një infeksion i shpendëve shtëpiakë dhe specieve të tjera të shpendëve me virusin virulent të sëmundjes Newcastle (NDV). Nuk është shqetësuese përmes sigurinë ushqimore apo shëndetin publik. Qytetaret si konsumatorë nuk kanë nevojë përmes shqetësim. Sëmundja është e karakterit social-ekonomik e cila rrezikon vetëm sektorin e fermave të shpeztarisë.

Të burgosurit korrën grurin në Dubravë, arrihet sasia prej 31.800 kg grurë

PRISHTINË, 21 KORRIK - Në Qendrën Korrektuese në Dubravë janë korrur 10 ha grurë, sasia e tërësishme e grurit nga korrige fshirjet përmes vitit 2024 ka arritur 31.800 kg grurë. "E gjithë puna, nga mbjellja deri te korrja, është kryer nga të burgosurit e kësaj qendre, nën udhëheqjen dhe

mbikëqyrjen e Njësisë Ekonomike të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) dhe stafit të Qendrës Korrektuese të Dubravës", bëhet me dije në njoftimin përmes SHKK-së. Rendimenti i prodhuar nga kjo kulturë bujqësore do të përdoret përmes nevojat e të gjitha

institucionave korrektuese. Shërbimi Korrektues i Kosovës, përmes punës së Njësisë Ekonomike, synon dita ditës të ndikojë në rehabilitimin dhe risocializimin e personave të burgosur, si dhe në uljen e shpenzimeve të buxhetit të SHKK-së.



BQK-ja ia transferon qeverisë mbi 10 milionë euro

PRISHTINË, 21 KORRIK - Ministri i Financave, Hekurani Murati, ka bërë të ditur se Banka Qendrore e Kosovës javën e kaluar ka transferuar në llogari të qeverisë shumën prej 10.38 milionë euro, në kuadër të ndarjes së fitimit vjetor, ashtu siç parashihet në ligjin përmes Bankës Qendrore të Republikës. Kjo shënon herë e parë në historikun e ri të shtetit tonë pas pavarësimit, që një transfer i tillë është mundësuar, falë performancës së mirë

"Edhe një lajm i mirë! Javën që shkoi, BQK ka transferuar në llogari të Qeverisë shumën prej 10.38 milionë euro, në kuadër të ndarjes së fitimit vjetor, ashtu siç parashihet në ligjin përmes Bankës Qendrore të Republikës. Kjo shënon herë e parë në historikun e ri të shtetit tonë pas pavarësimit, që një transfer i tillë është mundësuar, falë performancës së mirë

financiare të investimeve të BQK-së", ka shkruar Murati. Ndryshtë kuptojmë se të enjten, Qeveria ka njoftuar përmes dyfishimin dhe trefishimin e shtesave përmes fëmijëve. Familjet që kanë një ose dy fëmijë, Qeveria e Kosovës do të paguajë nga 20 euro shtesa përmes secilin në muaj. Ndërsa, përmes atë që kanë mbi tre fëmijë, shtesat do të janë 30 euro përmes secilin.





Nëna e Mbappes: Djali im gjithmonë ka ëndërruar të luajë për Real Madridin

PARIS, 19 KORRIK - Nëna e Kylian Mbappe ka thënë se ka qenë gjithmonë ëndrra e djalit të tij të luajë në Real

Madrid. Kujtojmë se francezi ka zbarkuar në fillim të kësaj javë në stadiumin "Santiago Bernabeu" pasi

nënshkruar një marrëveshje me klubin këtë verë nga Paris Saint-Germain (PSG). Në një bisedë me "Le Parisien", nëna

e Mbappes ka thënë se djali i tij ishte në kontakt prej kohësh me presidentin e Real Madridit, Florentino Perez.



Nisin garat 'FIBA 3x3 Challenger' në Prishtinë

PRISHTINË, 19 KORRIK - Në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë kanë nisur garat e basketballit "FIBA 3x3 Challenger". Në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare sportive janë duke marrë pjesë 18 shtete nga mbarë bota. Garat janë duke u zhvilluar dy konkurrenca, edicioni i tretë përmes meshkuj dhe edicioni i dytë përmes femra.

Ndeshjet kanë filluar me edicionin e dytë "FIBA 3x3 Women's Series". Gara është hapur me ndeshjen në mes të Kosovës dhe Polonisë, ndërsa të

premtën janë zhvilluar ndeshjet çerekfinale, gjysmëfinale dhe finale, përmes vazduhar pastaj edhe përmes dy ditë të tjera me "Men Challenger categories". Në hapjen e kësaj ngjarjeje kanë marrë pjesë kryeministri Albin Kurti, zëvendësministri Daulina Osmani, Fisnik Juniku nga "3x3 Prishtina", përfaqësues të klubeve pjesëmarrëse, basketballistë dhe sportdashës të basketballit.

"FIBA 3x3 Challenger" është mbështetur nga Ministria e Sportit.



Universiteti i Prishtinës, triumfues në kampionatin evropian universitar



PRISHTINË, 19 KORRIK - Ekipi i karateisteve të Universitetit të Prishtinës, i përbërë nga Fortesa Orana, Vlera Qerimi dhe Elmedina Istogu, ka rrëmbyer vendin e parë në Kampionatin Evropian Universitar të mbajtur në Hungari.

Karateistet tona kanë mposhtur ekipet nga Azerbajxhani, Hungaria dhe në finale Turqinë, duke u renditur kështu në krye

të kësaj gare. Vajzat e UP-së kanë shkëlqyer edhe në garat individuale. Karateistja Fortesa Orana ka fituar medaljen e argjendtë në kategorinë Kumite +68 kg, si dhe Vlera Qerimi ka fituar medaljen e argjendtë në kategorinë Kumite -68kg. Ndërsa me medalje të bronzët e shpërblye Elmedina Istogu, e cila garoi në kategorinë Kumite -

61kg. Fortesa, Vlera dhe Elmedina gjatë garave të tyre kanë mposhtur kundërshtaret nga Turqia, Austria, Gjermania, Bosnjë-Hercegovina, Rumania, Sllovenia dhe Mali i Zi. Pjesëmarrja e Kosovës në këto lojëra është mundësuar në bashkëpunim me Federatën e Sporteve Universitare të Kosovës dhe Federatën e Karatesë të Kosovës.

Papa Françesku: Lojërat Olimpike janë mundësi për unitet në Francë

ROMË, 19 KORRIK - Papa Françesku ka thënë të premtën se Lojërat Olimpike do të mund të ofrojnë mundësi për unitet kombëtar në Francë. Ai i ka bërë këto deklarata pak para nisjes së këtyre Lojërateve në Paris më 26 korrik. "Shpresoj që organizimi i këtyre Lojërateve do të jetë mundësi për të gjithë njerëzit në Francë që të kenë

harmoni, të kalojnë përpjek dallimeve dhe opozitës, dhe të lejohet forcimi i unitetit të kombit", ka thënë Papa përmes një letre.

Thirrja e tij vjen në kohën e dallimeve të theksuara në politikën franceze, meqë zgjedhjet e kanë lënë vendin pa një rrugë të qartë për formim të qeverisë.

Në thirrjen e Papës janë përsëritur thirrjet përritjen e armëpushimeve në botë, në kohën e mbajtjes së Lojërateve, të cilat i ka përshkruar si organizim "që natyrshëm sjell paqe dhe jo luftë". Lojërat Olimpike do të përfundojnë më 11 gusht. Këtë vit Kosova përfaqësoshet me nëntë sportistë.



Alvaro Morata transferohet në Milan

MILAN, 19 KORRIK - AC Milani ka njoftuar se ka nënshkruar kontratë me Alvaro Moratan e Atletico Madridit. Kapiteni i kombëtares spanjolle, me të

cilën së fundi ka fituar Kampionatin Evropian, Morata ka nënshkruar me kuqezintjtë deri më 30 qershor 2028, me opsjon përmes ta

vazduhar edhe përmes shtesë. Kapiteni aktual spanjoll ka luajtur 80 ndeshje përmes e tij kombëtar, duke shënuar 36

gola dhe ka fituar kampionatin e fundit evropian dhe Ligën e Kombeve UEFA 2022/23. Ai ka zgjedhur ta veshë numrin 7.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Lumé's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumé's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatr-it, 4 Llullat, Rr. Bayram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Law Firm Consulting E Hoti" L.L.C. me seli në Gjilan, me pronar Emine Hoti, ka marrë vendim të shua jë biznesin me nrb UNIK: 811497769 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Law Firm Consulting E Hoti" D.O.O. od Gnjilane, sa vlasnikom Emine Hoti, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811497769 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Law Firm Consulting E Hoti" L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Emine Hoti, has come to the decision to quit its business: 811497769 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enis Lahu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".
- Vilson Kurti shpall të pavlefshme dëftesat dhe certifikatën e testit të maturës dhe diplomën e shkollë së mesme "Arkitekt Sinani".
- Nevzat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme profesionale "Bahri Haxha"-ish shkolla e mesme "Muhamrem Bekteshi".
- Lëshoj lokalini më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katit tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çimim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afér Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, pér info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çimim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afér Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, pér info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çimim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afér Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çimimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Flidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA
1992

